# DËSHMI ARKIVI

**A-450558**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Arrestohet ish-kreu i Kadastrës së Fierit dhe një biznesmen ndërtimi, dyshohet se falsifikuan dokumentet e pronësisë në Seman në 2024-ën - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/shoqerohet-ne-komisariatin-e-fierit-ishdrejtori-i-kadastres-ertis-shehu` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 20:24:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 20:15:53 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8ac4b2caafdcdd37889935d1b4f4d6b4d5a070e2e5aeab07e053a0cba40f633e` |
| TEKSTI | `3872d6460e0c4c2aba22538901187bc31f91807b2e1fdac59af728fcb5d24b2c` |
| PAMJA | `7b478a31dfb988fc50013b6fea5012ebb4660f1267a35c5f875769617e3df81b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1ab4a20a8b703b98cde40818b02bc96f2e8d8ac367b7821a219567aa56b6028c` |
| E MËPARSHMJA | `f74a338d74b44ed14f933b8bad40868f614a4cab84e8b80a6ca4e98e4cadd9ea` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1ab4a20a8b703b98cde40818b02bc96f2e8d8ac367b7821a219567aa56b6028c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





Kronikë

# Arrestohet ish-kreu i Kadastrës së Fierit dhe një biznesmen ndërtimi, dyshohet se falsifikuan dokumentet e pronësisë në Seman në 2024-ën

*Ish-kreu i Kadastrës Fier, Ertis Shehu dhe biznesmeni Kastriot Hasko kanë qenë prej muajsh nën hetim nga Prokuroria e Fierit, ndërsa urdhër-arrestet janë ekzekutuar mbrëmjen e këtij të mërkure në Tiranë.*




*Foto ilustruese*

Redaksia
16 Shtator, 22:12 | **Përditesimi: 16 Shtator, 23:14**

Share Tweet

Ish-kreu i Kadastrës Fier, Ertis Shehu dhe biznesmeni Kastriot Hasko janë arrestuar nga Policia e Shtetit, me urdhër të Prokurorisë së Fierit. Burime për Report Tv bëjnë të ditur se prangosja e tyre është kryer në kuadër të hetimeve për një rast të dyshuar të falsifikimit të dokumenteve të pronësisë në Seman.

Shehu dhe Hasko kanë qenë prej muajsh nën hetim nga Prokuroria e Fierit, ndërsa urdhër-arrestet janë ekzekutuar mbrëmjen e kësaj të mërkure në Tiranë. Priten detaje të reja në lidhje me hetimin dhe përfshirjen e emrit të ish-zyrtarit të Kadastrës.

Burime bëjnë me dije se rasti falsifikimit të dokumentave të pronësisë në Seman është zbuluar në fund të vitit 2024, vetëm 2 muaj pasi drejtoresha e Përgjithshme e Kadastrës, Lorena Goxhobelli, kishte marrë detyrën, konstatuar nga një kontroll administrativ.



LEXO EDHE:
**FBI 'zbarkon' nesër në Tiranë, 235 pjesëmarrës të agjencive ligjzbatuese nga Europa dhe SHBA mblidhen në kryeqytetin e Shqipërisë**

Rasti në atë kohë është referuar në SPAK, por nuk dihet se çfarë ka ndodhur me kallëzimin, nëse Prokuroria e Posaçme ka nisur për të hetim apo jo. Paralelisht çështja është hetuar nga Prokuroria Fier, e cila pas muajsh verifikime ka konkluduar me urdhër-arrestet mbrëmjen e sotme.

Ertis Shehu ka shërbyer si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në Fier në periudhën 2019 – 2021, pra përreth 2 vite. Emërimi i tij erdhi gjatë reformës së ristrukturimit të



zyrave të regjistrimit të pasurive dhe krijimit të ASHK-së.

-------------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

R.Xh/Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Falsifikim dokumentesh | Tirane | ertis shehu | kadastra | Fier | Kastriot Hasko

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ 3.0 / 5 (5 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente** Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18
**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Tiranë/ Qiratë e larta 'detyrojnë' studentët t'u drejtohen konvikteve, rriten me 70% kërkesat për akomodim**

Joana Preja

20 Shtator, 16:44



**Zjarr masiv në vendgrumbullimin e mbeturinave në Fushë-Krujë, tymi përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit (VIDEO)**

20 Shtator, 16:11



**Bizneset e merrnin në punë, ajo vidhte xhiron e ditës dhe zhdukej! Arrestohet në Tiranë Kumrie Zika, policia: Janë dokumentuar 5 raste (VIDEO)**

20 Shtator, 14:13



**'Muzak Fest' rikthen artin në Apoloni! Emra të njohur të skenës shqiptare bashkojnë poezinë, muzikën dhe historinë**

Marsela Topi

20 Shtator, 14:07



**'Për sezonin tjetër, puna fillon tani', Demo vlerëson zjarrfikësit e Tiranës: Më shumë masa për parandalimin e zjarreve**

20 Shtator, 13:57



**Verdikti i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?**

20 Shtator, 13:40



**"Erdhi gjyshi dhe e goditi me thikë" nipi 14-vjeçar tregon minutat e fundit të Lumturie Patushit para se të vritej nga bashkëshorti në Tiranë**

20 Shtator, 13:23



**Aksident në Fier-Seman, makina del nga rruga dhe përfundon në kanal, plagoset shoferja (EMRI)**

20 Shtator, 12:25



**Komiteti i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri mblidhet në 21 dhe 22 shtator**

19 Shtator, 19:04



Tjetërsimi i tokës në Seman, lihen në burg ish-drejtorët e Kadastrës! 'Arrest shtëpie' biznesmenit

19 Shtator, 17:50



Kaloi rininë në internim, poeti vlonjat Neki Ngucaj zgjedh bibliotekën e Lushnjës për të promovuar 16 librat e tij

19 Shtator, 16:26



Vdekja e bashkëshortes së ish-portierit Alban Hoxha, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve! Dënimi për mjekim të pakujdesshëm

Sokol Dema

19 Shtator, 16:12

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.